



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE PROKURIMEVE

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikës Unaza e Madhe”

I mbajtur sot në datë 06.05.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “**Materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikës Unaza e Madhe**”, me fond limit **60,088,333** (gjashtëdhjetë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre), lekë pa TVSH.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 627,226.858 (gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e njëzetë e gjashtë pikë tetëqind e pesëdhjetë e tetë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 05.05.2026 është 95.80 euro.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. *Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. *Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore. Blerja tabelave dhe sinjalistikës rrugore ka si qëllim përmirësimin sinjalistikës si dhe zëvendësimin e pjeseve të ndryshme perberes. Problematikat kanë natyrë të perseritur. Si rrjedhim, pjesa dermuese e këtyre mallrave janë komplementarë

të njeri tjetrit, që do të thote instalohen apo montohen njëkohësisht dhe në mënyrë paralele në një sistem trotuaresh dhe furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet.

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do të duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, komplementare të njëra-tjetrës, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT